

**VENDIM I ORTAKUT TE VETEM TE
SHOQERISE "SHEGA TRANS" SH.P.K.**



Sot, me 23.04.2007, ne seline e shoqerise "SHEGA TRANS" SH.P.K., ne Tirane, u mbajt mbledhja e ortakut te vetem te kesaj shoqerie.

Shoqeria "Shega Trans" SH.P.K eshte person juridik shqiptar i regjistruar me Vendimin nr.24094, date 04.07.2000 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke dhe zoterohet 100% nga Ortaku i vetem i kesaj shoqerie i cili eshte Shoqeria "SHEGA GROUP" SH.A, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin nr. 32714, date 13 Janar 2005, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Administratori i shoqerise "Shega Trans" shpk eshte Z. Agron Xhango, shtetas shqiptar, i biri i Farudinit, lindur me 15.03.1958, lindur ne Shkoder, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Mbledhja u drejtua nga Z. Agron Xhango, ne cilesine e e Kryetarit te Mbledhjes. Ne kete mbledhje Ortaku i Vetem I shoqerise "Shega Trans" shpk e cila eshte shoqeria "Shega Group" sha u perfaqesua nga te dy aksioneret e kesaj te fundit. Kryetari i mbledhjes pasi konstatoi pranine e plote te gjithe pjesemarrsesve te shoqerise deklaroi mbledhjen e hapur duke u bere te ditur rendin e dites si me poshte:

RENDI I DITES:

1. Miratimi i Raportit te ekspertit kontabel te autorizuar i dates 19/04/ 2007 per bashkimin e llogarive te shoqerise "Shega Group" sha me llogarite e "Shega Trans" shpk
2. Emertimi i shoqerise se re i cili do te jete emri i shoqerise perthithese "Shega Group" sha.

Persa i perket pikes se pare te rendit te dites: Me vendimin Nr.24094/4 date 23.11.2006 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur miratimin e projektit per bashkimin e Shoqerise "Shega Group" SH.A dhe Shega Trans" shpk nepermjet perthithjes ku shoqeria "Shega Group" sha eshte shoqeria qe do perthithe shoqerine "Shega Trans" shpk.

Po me kete vendim Gjykata ka vendosur miratimin per emerimin si ekspert kontabel Z. Kosta Nikai cili do te pergatiste dhe raportin perfundimtar per bashkimin e llogarive te shoqerise "Shega Group" sha me llogarite e shoqerise "Shega Trans" shpk.

Drejtuesi i mbledhjes ia dha fjalen ekspertit te emeruar nga gjykata Z. Kosta Nika i cili lexoi raportin perkates per bashkimin e ketyre shoqerive . Midis te tjerave ai theksoi se pasi kishte kontrolluar te gjitha dokumentat ligjore dhe ekonomike te vena ne

dispozicion nga te dyja shoqerite ai kishte marre per baze ato qe qene pasqyruar ne bilancet ekonomike deri ne 31.12.2006. Po kjo date eshte dhe data e ngurtesimit te llogarive bankare. Kjo date korispodon me daten normale te mbylljes se vitit ushtrimor keshtu qe bashkimi eshte karakterizuar juridikisht nga njekohshmeria e shkrirjes se shoqerise qe perthithet "Shega Trans" shpk nga transferimi i pasurise se saj dhe nga ndryshimi i cilesise se aksionereve te saj. Kjo njekohshmeri eshte bere duke mbartur menjehere te gjitha llogarite e shoqerise qe perthithet (salimi i llogarive debitore dhe kreditore nga Shega Trans Sh.p.k tek llogarite e Shega Group Sh.A.).Shoqeria " Shega Group" sha zoteron 100% te kuotave te shoqerise qe perthithet " Shega Trans" shpk

Duke iu referuar Raportit te hartuar nga eksperti kontabel i autorizuar ai ka konkluduar se vlefte e kapitalit te shoqerise te zoteruar nga shoqeria perfituese eshte i barabarte prej **2.100.000 leke, i ndare ne 2.100 aksione me nje vlefte nominale secila prej 1.000 leke.**

Ky kapital zoterohet nga aksioneret e shoqerise perfituese pa ndryshuar vleren nominale per nje aksion, si dhe pa ndryshuar perqindjet e pjesemarrjes ne kapital si me poshte:

- Z. Gentian Borici, shtetas shqiptar, i biri i Tarikut, lindur me 23 Gusht 1971, lindur ne Fier, banues ne Tirane, i cili zoteron 50% te kapitalit te shoqerise ose 1050 aksione.
- Z. Shefqet Shijaku, shtetas shqiptar, i biri i Myslymit, lindur me 20 Qershor 1941, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, i cili zoteron 50% te kapitalit te shoqerise ose 1050 aksione.

Persa i perket pikes se dyte te rendit te dftes: Aksioneret e shoqerise kane rene dakorte qe emri i shoqerise se re te perfituar nga bashkimi i shoqerise "Shega Group" sha me shoqerine "Shega Trans" shpk te jete emri "Shega Group" sha.

Pas diskutimeve te ceshtjeve te mesiperme, dhe duke mos patur asnje kundershtrim aksioneret ne menyre unanime:

VENDOSEN:

1. Te miratojne Raportin e ekspertit kontabel te autorizuar te dates 19/4/2007 per bashkimin e llogarive te shoqerise "Shega Group" sha me llogarite e "Shega Trans" shpk duke krijuar nje shoqeri te vetme.

Vlefte e kapitalit te shoqerise te zoteruar nga shoqeria perfituese eshte i barabarte prej **2.100.000 leke, i ndare ne 2.100 aksione me nje vlefte nominale secila prej 1.000 leke.**

Ky kapital zoterohet nga aksioneret e shoqerise perfituese pa ndryshuar vleren nominale per nje aksion, si dhe pa ndryshuar perqindjet e pjesemarrjes ne kapital si me poshte:

- Gentian Borici, shtetas shqiptar, i biri i Tarikut, lindur me 23 Gusht 1971, lindur ne Fier, banues ne Tirane, i cili zoteron 50% te kapitalit te shoqerise ose 1050 aksione.
- Z. Shefqet Shijaku, shtetas shqiptar, i biri i Myslymit, lindur me 20 Qershor 1941, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, i cili zoteron 50% te kapitalit te shoqerise ose 1050 aksione.

2- Shoqeria e bashkuar do te kete emrin e shoqerise perthithese " Shega Group " sha

Duke mos patur ceshtje tjeter per te diskutuar, Kryetari i mbledhjes e deklaroi mbledhjen te mbyllur.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "SHEGA TRANS" SH.P.K.

SHOQERIA "SHEGA GROUP" SH.A
Perfaqesuar nga Aksioneret e Saj

Gentian Borici

SHOQERIA "SHEGA TRANS" SH.P.K.
TIRANE
TEL: 00 355 4 255003/9
FAX: 00 355 4 255010

Shefqet Shijaku

SHOQERIA "SHEGA TRANS" SH.P.K.
TIRANE
TEL: 00 355 4 255003/9
FAX: 00 355 4 255010